

VENDIM
Nr. 798, datë 14.11.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 713, DATË 16.10.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E MINISTRISË SË TURIZMIT,
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË FESTIVALIT
TË 13-TË TË FILMIT SHQIPTAR, FESTIVALIT MBARËKOMBËTAR TË DRAMËS SHQIPE
DHE REALIZMIN E DRAMËS FITUESE, SHPALLUR NË KONKURSIN ME RASTIN E 100-
VJETORIT TË PAVARËSISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 713, datë 16.10.2012 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e vendimit, pas fjalëve “...Ministrisë së Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve...” të shtohen “...dhe Qendrës Kombëtare të Kinematografisë...”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Institucioneve të mëposhtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’u shtohen fondet, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve t’i shtohet fondi në shumën 10 371 200 (dhjetë milionë e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të Festivalit Mbarëkombëtar të Dramës Shqipe dhe realizmin e dramës fituese, shpallur në konkursin me rastin e 100 - Vjetorit të Pavarësisë.

b) Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, në artikullin 604, “Projekte”, t’i shtohet fondi 5 475 000 (pesë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për mbulimin e shpenzimeve të Festivalit të 13-të të Filmit Shqiptar.”.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha